

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
 KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Doretuar Primitje/Prodato Received/Delivered	17. 01 2024	4	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/HA	307/2024		1/5



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1479/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1479/2023 të datës 05.12.2023 të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat

kundër Vendimit me Nr.1510/2023 të datës 08.11.2023 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 16.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr.1479/2023 e datës 05.12.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit më datë 11.08.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 122/2022 përmes të cilit ka emëruar Komisionin për Shqyrtimin dhe Vlerësimin në Kërkesave për Lëshimin e Vërtetimeve për Sponsorizimin në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me mandat dy vjeçar me mundësi rizgjedhjes ndërsa në pikën 7 të këtij vendimi është përcaktuar se lejohet kompensimin në vlerën prej 125 për kryesuesin ndërsa nga 100 euro për anëtarët e tjerë për secilën mbledhje.

Si rezultat i këtij vendimi, zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit më datë 25.08.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.992/2022 më të cilin ankuesen e

ka emëruar Sekretarë këtij Komisioni duke ja njohur të drejtën e kompensimit në vlerën prej 75 Euro por jo më shumë se katër mbledhje në muaj.

Përmes Vendimit me Nr. 1510/2023 të datës 08.11.2023 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit i është njohur kompensimin Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin në Kërkesave për Lëshimin e Vërtetimeve për Sponsorizimin në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa për rastin e ankueses më datë 16.11.2023 është nxjerr Vendimi me Nr. 1564/2023 nga zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm ku përmes tij është shfuqizuar Vendimi me Nr. 992/2022 i datës 25.08.2022 me arsyetimin se emërimi i Sekretares së komisionit nuk është paraparë me Rregulloren (MKRS) Nr.01/2018 për Përcaktimin e Kritereve, Procedurave dhe Formës së Vërtetimit të Sponsorizimit në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ankuesja më datë 16.11.2023 ka kërkuar nga zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm që në pajtim me vendimin e datës 25.08.2022 të kompensohet për periudhën Mars-Nëntor 2023, ndërsa zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm ka njoftuar ankuesen përmes emailit të datës 16.11.2023 se ky vendim nuk ka bazë për kompensim dhe i vetmi kompensim është puna jashtë orarit që është dashur të bëhet me kohë duke marr aprovimin paraprak sipas procedurave për punë shtesë.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr.510/2023 të datës 08.11.2023 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe pretendimeve për kompensim sipas Vendimit me Nr. 992/2022 të datës 25.08.2022 për periudhën nga muaji Mars deri më datë 16.11.2023, më datë 05.12.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7233/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.12.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.Ndërsa Këshilli më datë 18.12.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova:Ankesën me numër protokolli 7233/2023 të datës 05.12.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.1510/2023 të datës 08.11.2023 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Autorizimin e datës 30.11.2023Vendimin me Nr. 122/2022 i datës 11.08.2022; Vendimin me Nr. 116/2023 i datës 14.06.2023; Vendimin me Nr. 992/2022 i datës 25.08.2022; Vendimin me Nr. 1564/2023 i datës 16.11.2023; Emailin e datës 10.07.2023 nga ankuesja për F.H; Emailin e datës 10.07.2023 nga F.H për ankuesen; Kërkesën për pagesë e datës 08.11.2023 nga Kryetari i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin në Kërkesave për Lëshimin e Vërtetimeve për Sponsorizimin në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;

Kërkesën për kompensim e ankueses e datës 16.11.2023; Përgjigjen e datës 16.11.2023 nga zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm për ankuesen; Ankesën e datës 27.11.2023 të ankueses pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të MKRS; Emailin e datës 29.11.2023 nga Sh.I për ankuesen; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 11.12.2023; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 25.01.2018; Lista e pjesëmarrjes në takim të komisionit e datës 21-22.06.2023; datës nga 04-11.07.2023, e datës nga 11-24.08.2023, e datës nga 04-19.09.2023 e datës nga 02-26.10.2023; Takimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin në Kërkesave për Lëshimin e Vërtetimeve për Sponsorizimin në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i mbajtur më datë 05.06.2023, 01.06.2023, 08.06.2023, 12.06.2023, 15.05.2023,, 19.05.2023, 10.05.2023, 04.05.2023, 20.04.2023, 18.04.2023, 25.04.2023, 28.04.2023, 17.03.2023, 03.03.2023, 13.03.2023, 22.03.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses, është e papabuzuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se meqenëse është emëruar si Sekretare e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin në Kërkesave për Lëshimin e Vërtetimeve për Sponsorizimin në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit sipas Vendimit me Nr.992/2022 të datës 25.08.2022 është dashur të kompensohet sikurse anëtarët e këtij komisionit, ngase Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në opinionin e tij së cilit i referohet ankuesja parashihte që për funksion shtesë të kësaj natyre në MKRS të paguhen të gjithë anëtarët apo të emëruarit me funksione shtesë, por jo më shumë se një funksion shtesë. Tutje sipas ankesës kërkon të aprovohet ankesa dhe të kompensohet sipas Vendimit me Nr. 992/2022 të datës 25.08.2022 për periudhën nga muaji Mars deri më datë 16.11.2023.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në dispozitat e Rregullores (MKRS) Nr.01/2018 për Përcaktimin e Kriteve, Procedurave dhe Formës së Vërtetimit të Sponsorizimit në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit gjegjësisht me nenin 8 është paraparë formimi i Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave, mirëpo në asnjë paragraf të këtij neni nuk ishte paraparë të emërohet një Sekretare e këtij komisioni.

Duke marr parasysh që pretendimi i ankueses për kompensim ka të bëjë për periudhën nga muaji Mars deri më datë 16.11.2023, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se në këtë periudhë kohore i aplikueshëm është Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë dhe aktet nën ligjore për zbatimin e këtij ligji.

Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, përveç pagës bazë për zyrtarët publikë, ka përcaktuar edhe shtesat e parapara me nenin 22, i cili përcakton se: "1. Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/fit; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa funksionale", po ashtu sipas këtij ligji

janë përcaktuar edhe kompensimet si parashihet me nenin 35 i cili përcakton se: "kompensimet që mund të përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. kompensimi për kujdestari; 1.2. kompensimi për punë gjatë natës dhe jashtë orarit të punës; 1.3. kompensimi për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare; 1.4. kompensimi për udhëtime dhe shpenzimet e përfaqësimit; 1.5. kompensimi për funksionin shtesë; 1.6. kompensimi për anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; dhe 1.7. kompensimi për stafin tjetër të administratës që punojnë jashtë vendit".

Kolegji i Këshillit, konstaton se nuk mund të bëhet asnjë kompensim jashtë normave të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, rrjedhimisht ky ligj nuk ka paraparë një kompensim për nëpunësit civil me një shumë fikse si është përcaktuar me Vendimin me Nr. 992/2022 të datës 25.08.2022 për rastin e ankueses, kështu që sipas kriterëve ligjore dhe rregulloreve përkatëse në fuqi për zbatimin e këtij ligji të vetmet shtesa/kompensimet që mund të aplikoheshin në rastin konkret të ankueses është kompensimi për punë jashtë orarit të rregullt të punës, sepse në rastin konkret të ankueses nuk mund të aplikohen shtesa për vëllim në punë, apo edhe kompensimi për funksione shtesë për shkak që nuk plotësohen kushtet e parapara me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, respektivisht nuk plotësohen kushtet as për kompensim të funksionit shtesë si parashihet me nenin 4, 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksionin Shtesë.

Ndërsa sa i përket kompensimit për punë jashtë orarit të rregullt të punës, Kolegji i Këshillit, ju referua Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për Kompensimin për Kujdestari, Punën gjatë Natës dhe Punën Jashtë Orarit të Punës, gjegjësisht: Nenit 7 paragrafi 1, 2 dhe 3,ku përcaktohet: "Kompensimi për punën jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës 1. Zyrtarët publik dhe kategoritë e tjera të të punësuarve që paguhen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, kanë të drejtë të kompensohen për punën jashtë orarit të rregullt të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës. 2. Puna jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës mund të realizohet vetëm kur i punësuarit ka pëlqim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe ka autorizim paraprak të arsytuar nga udhëheqësi më i lartë i institucionit. 3. Kompensimi për punën jashtë orarit të rregullt të punës, punën gjatë festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës bëhet me pagesë ose me ditë pushimi", nenit 8 paragrafi 1, 2 dhe 3,ku parashihet se: "1. Kompensimi për punë jashtë orarit të rregullt të punës, gjatë festave zyrtare apo gjatë ditëve të fundjavës bëhet vetëm në rastet kur plotësohen kriteret e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 7 të kësaj Rregulloreje. 2. Kërkesa për kompensim për punë jashtë orarit të rregullt të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës aprovohet nga zyrtari më i lartë administrativ i institucionit më së largu dhjetë (10) ditë pas përfundimit të orëve shtesë, duke plotësuar Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje. 3. Kompensimi për punën jashtë orarit të rregullt të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës duhet të ekzekutohet më së largu gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e aprovimit të kërkesës".

Kolegji i Këshillit, konstaton se edhe pse si prova materiale të lëndës bëjnë pjesë edhe shkresat për takimet e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin në Kërkesave për Lëshimin e Vërtetimeve për Sponsorizimin në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të mbajtur më datë 05.06.2023,01.06.2023,08.06.2023,12.06.2023,15.05.2023,19.05.2023,10.05.2023,04.05.2023,20.04.2023, 18.04.2023,25.04.2023,28.04.2023,17.03.2023, 03.03.2023, 13.03.2023, 22.03.2023, e ku në këto takime ka marr pjesë edhe ankuesja, nuk mund të vërtetohet nëse këto takime kanë qenë brenda apo

jashtë orarit zyrtar të rregullt të punës, andaj bazuar në dispozitat ligjore si më sipër po ashtu edhe provave materiale të lëndës, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për kompensimin e ankueses as për punë jashtë orarit të rregullt.

Prandaj lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në opinionin e tij parashihte që për funksion shtesë të paguhen të gjithë anëtarët apo të emëruarit në funksion shtesë, Kolegji i Këshillit, konstaton se kompensimi për funksionin shtesë bëhet vetëm me plotësimin e kushteve të parapara me dispozitat e cekura si më lartë, andaj në rastin konkret të ankueses nuk janë plotësuar, kështu që për rrjedhojë pretendimet e saj janë të papabazuara edhe në këtë aspekt.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.1479/2023, datë 16/01/2024

**Avdyll BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Arben MEHMETI**  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.